

U DHËZIM

për dhënien e pëlqimeve për ndërtim të objekteve në afërsi të Nënstacioneve, Linjave të Tensionit të lartë dhe nën Linja të Tensionit të Lartë

Në bazë të:

- Ligjit për Energjinë 05/L-081, neni 31 dhe 32,
- Udhëzimit Administrativ (MZHE) Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, neni 4, 5 dhe 6,
- Rregullorja për Ndërtim në Afërsi të Stabilimenteve Energjetike të Tensionit të Lartë
- Kodit të Pajisjeve Elektrike të KOSTT-it, dhe
- Standardit SK EN 50341,

Investitori/paraqitësi i kërkesës, i cili synon të ndërtojë objekte në afërsi të trafostacioneve 400/220 kV, 400/110 kV, 220/110 kV, 220/35/10(20) kV, 110/X kV dhe në afërsi apo nën linja të tensionit të lartë 110, 220 dhe 400 kV përfshirë zhvendosje, është i obliguar që ndër të tjera të sigurojë edhe pëlqimin prej KOSTT-it për plotësimin e kushteve për ndërtimin e objektit në atë hapësirë.

Me qëllim të lehtësimit dhe veprimit të drejtë për dhënien e pëlqimit përkatës jepet ky udhëzim, i cili do të zbatohet prej datës kur Bordi i Drejtorëve në KOSTT e aprovon.

Investitori/paraqitësi i kërkesës, i cili synon të ndërtojë objektet në afërsi të stabilimenteve elektroenergjetike të KOSTT-it është i obliguar të kërkojë pëlqimin për plotësimin e kushteve për ndërtimin e objektit në atë hapësirë dhe me këtë paraprakisht paraqitësi i kërkesës duhet të bëjë pagesën sipas çmimoreve të bashkangjitur në udhëzim.

Bërja e kësaj pagesë nga paraqitësi i kërkesës, nuk e obligon KOSTT-in për të dhënë pëlqimin për ndërtim, nëse nuk plotësohen kushtet teknike sipas ligjit dhe standardeve në fuqi.

Kërkesa për pëlqim i adresohet KOSTT-it nëpërmes arkivit në formë të shkruar duke përfshirë kopjen e planit përkatësisht kopjen e situacionit të terrenit dhe dokumentacionin tjetër investues – teknik, duke përfshirë të dhënat kontaktuese të palës kërkuese .

Pala juridike kërkesën me arsyetim për pëlqim dhe dokumentacionin tjetër përkatës e paraqet me memorandum – fletë të palës zyrtare me nënshkrim të personit të autorizuar dhe të vërtetuar me vulë.

Komisioni i dedikuar dhe përkatës i caktuar nga Kryeshefi në KOSTT i qaset përpunimit të kërkesës dhënies së përgjigjes (pëlqimit/refuzimit) në harmoni me ligjin, standardet dhe rregullat teknike, brenda afatit të përcaktuar me ligj dhe rregullore të veçanta të KOSTT-it.

Gjatë përpunimit të kërkesës përcaktohet vlera e shërbimit sipas tarifave të përcaktuara më poshtë, të cilën paraqitësi i kërkesës duhet ta paguaj. Kjo vlerë e shërbimit i dorëzohet paraqitësit të kërkesës për pagesë para se të jepet përgjigja me shkrim.

Paraqitësi i kërkesës kryen obligimin për pagesë në xhirollogarinë e KOSTT-it: Raiffesisen Bank, RBKO 1501001006149310, Prishtinë, për të cilën dëshmon përmes dëftesës për pagesë dhe pastaj merr konfirmimin me shkrim nga Departamenti Financiar në KOSTT.

Kur paraqitësi i kërkesës lajmërohet përsëri me kushte tjera dhe me dokumentacion plotësues, faturimi përkatësisht pagesa bëhet përsëri sikurse për herë të parë.

Çmimet e shërbimit në dhënien e pëlqimeve (konfirmimeve) dhe shikimin e dokumentacionit për ndërtimin e objekteve në afërsi të objekteve elektroenergjetike.

1. Për persona fizik	150.00 Euro
2. Për persona juridik	300.00 Euro

Çmimet e mësipërme përfshijnë edhe TVSH.

Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it dhe publikimit në ueb – faqen e KOSTT-it.